



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
ZYRA ARSIMORE LUSHNJE

TESTI I OLIMPIADËS KOMBËTARE TË FIZIKËS FAZA E I KLASA E XI

Dt. 12.12.2018

1. Në një kordë përhapen valë sinusoidale. Një thërmije të kordës i duhet 0,34s për të kaluar nga pozicioni i zhvendosjes maksimale në pozicioni ekuilibri. Sa është perioda dhe frekuenca e këtyre lëkundjeve ? Nëse gjatësia e valës është 2.8m, sa do të jetë shpejtësia e përhapjes së saj? (10 pikë)
2. Valët e ujit përplasen në breg të dytë në mënyrë të tillë që shpejtësia e tyre ndryshon nga $v_1=2,5\text{m/s}$ në $v_2=2.1\text{m/s}$. Në qoftë se këndi i rënies në breg është 35° sa do të jetë i përthyerjes? (10 pikë)
3. Një rreze drite bie pingul mbi një faqe prizmi dhe del nga faqja tjetër duke u shmangur me 25° nga drejtimi i rënies. Treguesi i përthyerjes së qelqit të prizmit është 1,7 . Të gjendet këndi midis faqeve të prizmit. (10 pikë)
4. Një shufër zotëron ngarkesën $-2,4\mu\text{C}$. Sa elektrone duhet të zhvendosim ,në mënyrë që ngarkesa e saj të bëhet $+3,4 \mu\text{C}$ (10 pikë)
5. Janë dhënë rezistencat $R_1=6\Omega$, $R_2=8\Omega$, $R_3=4\Omega$, $R_4=12\Omega$ dhe të lidhura si në figurë . Tensioni i zbatuar në skajet A B të lidhjes është 12V. Sa është rezistenca e një vlerëshme e qarkut? Sa është rryma në degën kryesore dhe rryma në secilën degë? Sa është tensinoni në rezistencën R_3 ? Sa është tensinoni në rezistencën R_1 ? (10 pikë)

